



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, dhe nenit 48 paragrafi 2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 25, paragrafi 1 pika c, nenit 27 paragrafi 1, nenit 78 paragrafi 5, të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të Raportit përfundimtar për realizimin e buxhetit të Komunës së Prizrenit, për vitin fiskal 2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR RRETH REALIZIMIT TË
BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN FISKAL 2017

Neni 1

Miratohet Raporti Përfundimtar për Realizimin e Buxhetit të Komunës së Prizrenit, për vitin fiskal 2017, si:

I. TOTALI	
- Të hyrat e përgjithshme	40.147.739 - euro
- Shpenzimet e përgjithshme	36.765.293 - euro
- Diferenca – mjetet e mbetura	3.382.085 - euro
II. Për Administratën është si vijon:	
- Të hyrat e përgjithshme -	17.883.021 - euro
- Shpenzimet -	15.225.954 - euro
- Diferenca – mjetet e mbetura	2.657.067 - euro
III. Për Arsim është si vijon:	
- Të hyrat e përgjithshme -	16.634.496 - euro
- Shpenzimet -	16.149.708 - euro
- Diferenca – mjetet e mbetura	484.788 - euro
IV. Për Shëndetësi është si vijon:	
- Të hyrat e përgjithshme -	4.411.127 - euro
- Shpenzimet -	4.260.118 - euro
- Diferenca – mjetet e mbetura	151.009 – euro

V. Për Shërbimet Sociale është si vijon

- Të hyrat e përgjithshme -	1.218.735. - euro
- Shpenzimet -	1.129.513 - euro
- Diferenca – mjetet e mbetura	89.222 – euro

Neni 2

Diferenca - mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake nga vitet paraprake në njësitë buxhetore: (të Administratës , Arsimit, Shëndetësisë dhe të Shërbimeve Sociale) në shumën prej 3.229.709.01 euro, ridestnimi i mjeteve të mbetura do të bëhet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimit do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81, dhe 82 të LVL-së, i njëjti do të shpallet në “Kumtar“ dhe Web faqen e komunës.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/011-62764

Më 26 prill 2017

Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi